



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.109/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kimete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Interneës Kosova IKS, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë – dega në Komunën e Mitrovicë, për shkak të vendosjes së posterit të kandidatit të tyre në afërsi të objekteve publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.09.2019, mori këtë:

## VE N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.109/2019 e datës 27.09.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Interneës Kosova IKS, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë – dega në Komunën e Mitrovicë.

## A r s y e t i m

Me datën 27.09.2019, Organizata Joqeveritare BIRN dhe Interneës Kosova ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 27 Shtator 2019, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi sepse në hyrje të shkollës fillore “Anton Zako Çajupi”, kanë vendosur në poster të kandidatit për deputet Fidan Ademi nga Lëvizja Vetëvendosje, të ngjitura në hapësirat publike. Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se nga Lëvizja Vetëvendosje, ka bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073. Me propozim që te pranohet e bazuar ankesa.

Në përgjigjen në ankesë, subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, të datës 28.09.2019, theksonë se kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje, Fidan Ademi, më datë 25.09.2019, ka lidhur marrëveshje kontraktuale me qira me kompanin reklamuse “Umbrella” për shfrytëzimin e hapësirave reklamuse në rrugën “Mbretresha Teutë dhe Shemsi Ahmeti”. Pikërisht, Billbordi, e jo posteri siç pretendon parashtruesi është vendosur mbi bazën e kontratës mbi dhënien me qira të hapësirave reklamuese në rrugën “Shemsi Ahmeti”, konkretisht në vendin e autorizuar nga Komuna e Mitrovicës në marrëveshje me kompaninë “Umbrella”.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se e njëjta është e pabazuar për këto arsye:

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesë, por të njëjtat janë të pabazuar, dhe nuk përbëjnë shkelje te nenit 33 pika (b) të LZP-së, siç pretendohet në ankesë sepse bilbordi i

kandidatit të subjektit politik Vetëvendosje, është vendosur në vendin e dedikuar për reklamim të materialit propagandistik për fushatë zgjedhore.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës se posterit është vendosur 3 metra larg në hyrje të shkollës fillore “Anton Zako Çajupi” në Mitrovicë, në hapësira apo vende publike, Paneli vlerëson se në këtë periudhë kohore këto veprime nuk janë në kundërshtim me dispozita ligjore siç pretendon paraqitësi i ankesës ngase këto veprime janë të ndaluara vetëm para fillimit të votimit dhe gjatë ditës së votimit, nëse objekti në të cilën pretendohet se është vendosur afër bilbordit, shërben si Qendër e Votimit, ku sipas nenit 85 paragrafi 1 të LZP-së, përcaktohet, se: *“Të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohet nga anëtarët e KVV-ve ose Menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji”*

Nga arsyet e theksuar më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.109/2019 më datën 30.09.2019

**Kryesuesi i Panelit**

Zyhdi Haxhiu



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së.